REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVECOPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6576 Nr. i faq/Br.str/No.pg 160
Data/Datum/Date 22 / 09 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
*Republika Kosova – Republic of Kosovo*

**Komuna e Rahovecit**
*Opština Orahovac – Municipality of Rahovec*

**KRYETARI I KOMUNËS**
*Presednik Opštine – Municipal Mayor*

## LISTA E VENDIMEVE TË MARRA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT, Z. SMAJL LATIFI

## NGA DATA 15.09.2025 DERI MË 19.09.2025

| NR. | EMRI I VENDIMIT | NR. I PROTOKOLLIT |
|---|---|---|
| 1. | Vendim për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: "Mbikëqyrja e investimeve kapitale". | NRP-02-6564-2025 |
| 2. | Vendim për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: "Mbikëqyrja e investimeve kapitale". | NRP-02-6565-2025 |
| 3. | Vendim për për shfuqizimin e vendimit 02/6457 të datës 25.08.2025. | NRP-02-6567-2025 |
| 4. | Vendim për miratimin e kërkesës për dhënien e pushimit nga puna pa pagesë. | NRP-02-6568-2025 |
| 5. | Vendim për caktimin e komisionit për verifikimin e kulturës së parcelës. | NRP-02-6571-2025 |
| 6. | Vendim për dhënien e çmimit "Artisti i Vitit". | NRP-02-6473-2025 |

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6564 Nr. i faq/Br.str/No.pg 159
Data/Datum/Date 17 / 09 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 28 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011")*, nenit 19 paragrafi 19.16 i Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: "Mbikëqyrja e investimeve kapitale"**

1. Jetmir Ukaj, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Zyrtar teknik i ndërtimtarisë, në Drejtorinë për Administratë, **emërohet** person përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: "Mbikëqyrja e investimeve kapitale".

2. Personi përgjegjës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, ka për detyrë që të bëjë hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik dhe Rregulloren Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

3. Përgjegjësitë e personit për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, janë:

   **3.1.** Në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomikë, në përputhje me nenin 28 Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe akteve nënligjore (legjislacionit dytësor);

   **3.2.** Në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomikë;

   **3.3.** Të cilat nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, një procesi të hollësishëm, ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë, ose ndonjë prodhimi.

4. Personi përgjegjës obligohet që të hartojë specifikimet teknike / termat e referencës deri më datë 22.9.2025.

5. Personi përgjegjës obligohet që, së bashku me specifikimet teknike / termat e referencës, të dorëzojë edhe deklaratën në betim, të nënshkruar te Njësia e Prokurimit.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Jetmir Ukaj,***
- ***Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit,***
- ***Njësia e Prokurimit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6565 Nr. i faq/Br.str/No.pg 159
Data/Datum/Date 17 / 09 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 28 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011")*, nenit 19 paragrafi 19.16 i Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

## V E N D I M
**Për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: "Mbikëqyrja e investimeve kapitale"**

1. **Sokol Thaqi**, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Koordinator i projekteve, në Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, **emërohet** person përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: **"Mbikëqyrja e investimeve kapitale".**

2. Personi përgjegjës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, ka për detyrë që të bëjë hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik dhe Rregulloren Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

3. Përgjegjësitë e personit për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, janë:

   **3.1.** Në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomikë, në përputhje me nenin 28 Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe akteve nënligjore (legjislacionit dytësor);

   **3.2.** Në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomikë;

   **3.3.** Të cilat nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, një procesi të hollësishëm, ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë, ose ndonjë prodhimi.

4. Personi përgjegjës obligohet që të hartojë specifikimet teknike / termat e referencës deri më datë 22.9.2025.

5. Personi përgjegjës obligohet që, së bashku me specifikimet teknike / termat e referencës, të dorëzojë edhe deklaratën në betim, të nënshkruar te Njësia e Prokurimit.

6. Shfuqizohet vendimi me nr. 6564 i datës 17.9.2025.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Sokol Thaqi,***
- ***Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit,***
- ***Njësia e Prokurimit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6567 Nr. i faq/Br.str/No.pg 159
Data/Datum/Date 18 / 09 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 44, nenit 53 paragrafi 1 dhe 3 dhe nenit 57 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative të datës 25.05.2016 dhe nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**

1. **Shfuqizohet** urdhëresa me nr. prot. 02/6457 e datës 25.8.2025, për shpalljen e tenderit: 'Rregullimi i çatisë në palestrën sportive "Mizahir Isma"', në vlerën e parashikuar prej 97,000.00€ (nëntëdhjetë e shtatë mijë euro).

2. **Shfuqizohet** vendimi me nr. prot. 02/6458 i datës 25.8.2025, për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikave teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit 'Rregullimi i çatisë në palestrën sportive "Mizahir Isma"'.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Prokurimit, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Zyra e Prokurimit,***
- ***Drejtoria për Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivi.***

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E RAHOVECIT - KRYETARI I KOMUNËS

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6568 Nr. i faq/Br.str/No.pg 159
Data/Datum/Date 18 / 09 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 40 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 15 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publikë, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, si dhe kërkesës së Florjetë Morinës me nr. prot. 3158, të datës 15.9.2025, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për dhënien e pushimit nga puna pa pagesë**

1. **Miratohet** kërkesa për pushim pa pagesë e zonjës Florjetë Morina nga Rahoveci, e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: 'Mësimdhënëse në lëndët e gjeografisë dhe e edukatës qytetare në ShFMU "Bekim Sylka" në Rahovec', nga data 1.10.2025 deri më datë 30.9.2026.

2. Të lartpërmendurës në pikën 1 të këtij vendimi i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Obligohet zyrtari/ja për paga në Komunën e Rahovecit që ta largojë nga lista e pagës zyrtaren e lartpërmendur për periudhën e lartcekur.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Njësia e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***A r s y e t i m***

Florjeta Morina nga Rahoveci, e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: 'Mësimdhënëse në lëndët gjeografi dhe edukatë qytetare në ShFMU "Bekim Sylka" në Rahovec', ka parashtruar kërkesë me nr. prot. 3158 të datës 15.9.2025, me të cilën ka kërkuar pushim pa pagesë në kohëzgjatje nga data 1.10.2025 deri më datë 30.9.2026.

Kërkesën e lartpërmendura e ka parashtruar për arsye personale, respektivisht për shkak të rrethanave familjare të domosdoshme.

Gjatë kësaj periudhe, të lartpërmendurës i pushojnë të drejtat dhe detyrat e marrëdhënies së punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

Pas administrimit të të gjitha provave, duke u bazuar në nenit 40 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nenit 15 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publikë, është konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që zyrtarja publike ta shfrytëzojë pushimin pa pagesë për arsye personale.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Florjetë Morina,***
- ***Drejtoria për Arsim,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa,***
- ***Zyrtari/ja për paga,***
- ***Njësia e Personelit, dhe***
- ***Arkivi***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6571 Nr. i faq/Br.str/No.pg 160
Data/Datum/Date 19 / 09 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe kërkesës së Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural të datës 18.9.2025, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM
## Për caktimin e komisionit për verifikimin e kulturës së parcelës

1. **Caktohet** komisioni për verifikimin e kulturës së parcelës, duke u bazuar në kërkesën me nr. prot. 11-580/02-0035714/25, të datës 3.9.2025, në përbërje prej:
    1.1. Veton Mustafa, kryesues,
    1.2. Blerim Sokoli, anëtar,
    1.3. Dhurata Rrustemi, anëtare.

2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë verifikimin e kulturës së parcelës duke u bazuar në kërkesën me nr. prot. 11-580/02-0035714/25 të datës 3.9.2025.

3. Obligohet komisioni që pas përfundimit të punës të hartojë raport me shkrim për kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë më datë 26.9.2025.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***
- ***Anëtarët e komisionit,***
- ***Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, dhe***
- ***Arkivi.***

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA - KOMUNA E RAHOVECIT - KRYETARI I KOMUNËS

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna Rahovec***
*OpštinaOrahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6573 Nr. i faq/Br.str/No.pg 160
Data/Datum/Date 19 / 09 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008")*, nenit 4 paragrafi 9, nenit 5 dhe nenit 7 të Rregullores për dhënien e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit me Nr. Prot. 01 Nr. 327/22 të datës 31.5.2022, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

# V E N D I M
## Për dhënien e çmimit "Artisti i vitit"

**1.** Me këtë vendim, çmimi "Artisti i vitit" i ndahet regjisorit Gjergj Mena nga Tirana.

**2.** Ky çmim jepet për kontributin e madh dhënë kulturës kombëtare, respektivisht pasurimit të jetës kulturore në komunën e Rahovecit dhe punës së tij të madhe për themelimin e teatrit rinor të të rinjve në komunën e Rahovecit.

**3.** Bartësi i çmimi "Artisti i vitit" nënshkruhet formalisht në regjistrin e bartësve të titujve të nderit të Komunës së Rahovecit.

**4.** Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Regjisorit Gjergj Mena,***
- ***Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO - KOMUNA E RAHOVECIT - KRYETARI I KOMUNËS / OPŠTINA ORAHOVAC / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPALITY RAHOVEC - RAHOVEC